

# ZIGMUND FROJDD

---

HYRJE  
NË  
PSIKOANALIZË  
*Leksione*



---

*Vëllimi 2*

## Leksioni 16

### PSIKOANALIZA DHE PSIKIATRIA

Të nderuar zonja e zotërinj!

Jam i gëzuar që po ju shoh përsëri pas një viti dhe kam mundësi të rifilloj bisedat tona. Vitin e kaluar ju kam folur për konceptin psikopatologjik të veprimeve të gabuara dhe të ëndrrave, tani do të dëshiroja t'ju njihja me dukuritë neurotike që, siç do ta shihni më vonë, kanë shumë tipare të përbashkëta si me të parat, ashtu edhe me të dytat. Por po ju paralajmëroj se kësaj here nuk mund t'ju sugjeroj ndaj meje të njëjtin qëndrim si vitin e kaluar. Atëherë isha i detyruar të mos bëja as edhe një hap pa qenë dakord që më parë me ju; unë kam diskutuar shumë me ju, i kam marrë parasysh kundërshtimet tuaja; madje kam shkruar deri aty sa kam parë te ju dhe te "arsyeja" juaj "e shëndoshë" instancën më të lartë. Por sot nuk mund të jetë e njëjta gjë, dhe kjo për një arsye fare të thjeshtë se dukuritë, veprimet e gabuara dhe ëndrrat nuk kanë qenë të panjohura për ju; mund të thuhet se ju kishit ose mund të fitonit me lehtësi po aq përvojë sa edhe unë. Kurse fusha e dukurisë neurotike është e huaj për ju; meqenëse nuk jeni mjekë, ju nuk keni mundësi tjetër për t'u njohur me to, përveç atyre që do t'ju them unë, gjë që do të thotë se ai është gjykimi më i mirë sa kohë që nuk njihet materiali që duhet shqyrtuar.

Por mos kujtoni se kam ndërmend t'ju mbaj leksione dogmatike dhe as t'ju kërkoj t'i pranoni ato patjetër. Në rast se do t'i merrnit kështu, do të lindte një keqkuptim që do të ishte padrejtësi ndaj meje. Unë as që kam ndërmend të imponoj bindje; mua më mjafton sa të arrij të nxis te ju një mendim dhe të lëkund paragjykimet. Në qoftë se për shkak të një mosnjohjeje reale nuk jeni në gjendje të gjyconi vetë, ju nuk duhet as të besoni, as të mohoni. Ju duhet të dëgjoni e të lini të vepronjë mbi ju ato që do t'ju them unë. Nuk është e lehtë të krijohen bindje, dhe në qoftë se krijohen pa vëshirësi, ato dalin shumë shpejt pa vlerë e të paafta për të qëndruar. Të drejtë për bindje ka vetëm ai që, ashtu si unë, ka punuar shumë vite me të njëjtin material dhe ka marrë pjesë vetë në përsëritjen e eksperimenteve, duke fituar po atë përvojë të habitshme, për të cilën do t'ju flas. Përse shërbejnë, në përgjithësi, në fushën intelektuale këto bindje të shpejta, këto kthesa të rrufeshme në një besim të ri, këto largime të menjëhershme prej tij? A nuk e shikoni që "*coup de foudre*", dashuria me shikim të parë vjen nga një fushë krejt tjetër, e pikërisht nga ajo afektive? Ne nuk kërkojmë as nga pacientët tanë të jenë të bindur për efikasitetin e psikoanalizës apo të bëhen përkrahës të saj. Po ta bënim këtë, do të lindnin dyshime. Qëndrimi që vlerësojmë më shumë te ta, është skepticismi dashamirës. Kështu që provojeni edhe ju të lini të rriten te ju pikëpamjet psikoanalitike krahas pikëpamjeve popullore apo psikologjike, derisa të vijë rasti që të dyja llojet e pikëpamjeve të hyjnë në marrëdhënie të ndërsjellta, të harmonizohen midis tyre e të bashkohen duke bërë të lindë një koncept përfundimtar.

Por, nga ana tjetër, do të ishte gabim të kujtonim se pikëpamjet psikoanalitike që po shtjelloj, janë një sistem spekulativ. Përkundrazi, ato janë fakte të nxjerra nga përvoja, ose përshtypje e drejtpërdrejtë nga vëzhgimi ose rezultat i përpunimit të tij. Vetëm me zhvillimin e shkencës do të sqarohet nëse ky përpunim ka qenë i mjaftueshëm ose i përligjur dhe

pasi të kenë kaluar mbi dy dekada e gjysëm e të kemi lënë pas një jetë tepër të gjatë, do të guxoj të them pa mburrje se puna që na është dashur për këto vëzhgime, ka qenë tepër e rëndë, intensive dhe e thelluar. Shpesh kam patur përshtypjen se kundërshtarët e mi as që duan ta marrin parasysh këtë burim të bindjeve tona, sikur të ishte fjala vetëm për disa ide thjesht subjektive, të cilave mund t'u kundërvësh lirisht mendime të tjera. Nuk arrij ta kuptoj mirë këtë qëndrim të kundërshtarëve tanë. Ndoshita, kjo vjen ngaqë mjekët nuk pranojnë të hyjnë në marrëdhënie tepër të ngushta me pacientët e tyre, të prekur nga neuroza dhe ngaqë, duke mos i kushtuar vëmendje të mjaftueshme asaj që ata duan të thonë, u duket e çuditshme dhe e pamundur të nxjerrësh nga ato që ata thonë ndonjë gjë me vlerë dhe të bësh mbi sëmundjet vrojtime serioze që do të shërbenin si pikënisje për përfundime me vlerë përgjithëse. Në lidhje me këtë ju premtoj se gjatë këtyre leksioneve që do të mbaj, nuk do të bëj shumë diskutime polemizuese, sidomos me autorë të veçantë. Unë nuk besoj te drejtësia e tezës se polemika është nëna e të gjitha gjërave. Gjithnjë më është dukur se ajo vjen nga sofistika greke dhe vuan, si dhe ajo, nga mbivlerësimi i dialektikës. Kurse mua, përkundrazi, më është dukur se e ashtuquajtura polemikë shkencore në përgjithësi është tepër shterpë, pa folur se gati gjithnjë ka prije të jetë tepër personale. Para disa vitesh edhe unë mund të mburresha se dikur kam bërë debat të vërtetë shkencor me të vetmin shkencëtar (*Lévenfeld*, nga Mynihu) që pati si përfundim që nga kundërshtarë u bëmë miq dhe që miqësia jonë ruhet edhe sot e kësaj dite. Po meqënëse nuk kam qenë aq i sigurt se do të kem të njëjtin përfundim, kam kohë që ruhem ta përsëris të njëjtin eksperiment.

Ju me siguri do të mendoni se një shmangie e tillë nga çdo diskutim shkencor në literaturë tregon ose intolerancë tepër të madhe ndaj objeksioneve, ose një mendjemadhësi ekstreme ose, siç shprehen me mirësjellje në shkencë, që "s'je fort në rregull". Për këtë do të doja t'ju përgjigjesha se, në qoftë se ju

do të krijoni ndonjëherë një bindje me kaq vështirësi, edhe do të keni deri-diku të drejtë ta ruani atë fort kundër të tjerave. Pastaj do të doja të shtroja si argument edhe faktin se gjatë punës sime i kam ndryshuar, modifikuar ose zëvendësuar me të tjera disa nga pikëpamjet e mia për çështje tepër të rëndësishme dhe se nuk kam harruar kurrë të mos i bëj publike. Po cili ka qenë rezultati i këtij sinqeriteti? Disa as që kishin marrë vesh gjë për ndreqjet që kisha bërë dhe edhe sot vazhdojnë të më kritikojnë për pohime që kam kohë që nuk i vlerësoj më si më parë. Të tjerë më qortojnë pikërisht për këto ndryshime dhe deklarojnë se kjo tregon se ato që them nuk duhen marrë aq seriozisht. A nuk është e drejtë të thuhet se ai që ka ndryshuar disa herë pikëpamjet e veta, nuk meriton kurrfarë besimi, sepse kjo të bën të mendosh se edhe pohimet e tij të fundit mund të jenë të gabuara si të mëparshmet? Por, nga ana tjetër, ai që ruan pa u lëkundur ato që ka thënë një herë, quhet kokëfortë dhe jo fort në rregull: Po ç' duhet bërë atëherë përpara këtyre dy gjykimëve të kundërta të kritikës? Mendoj se duhet zgjedhur një rrugë: të mbetesh ai që je dhe të veprosh siç ta thotë mendja jote. Këtë unë e kam vendosur dhe asgjë nuk do të më pengojë të ndryshoj e të ndreq të gjitha teoritë e mia kur të ma kërkojë pasurimi dhe zgjerimi i përvojës sime. Në pikëpamjet e mia themelore nuk kam gjetur ende asgjë që duhet ndryshuar dhe shpresoj se kështu do të jetë edhe në të ardhmen.

Pra, duhet t'ju paraqes konceptin tim psikoanalitik të dukurive neurotike. Nuk është e lehtë që kjo paraqitje të lidhet me dukuritë, për të cilat ju kam folur tashmë si për shkak të analogjisë, ashtu edhe të kontrastit të tyre. Po e filloj me një veprim simptomatik që e vërej te mjaft njerëz gjatë konsultës. Me ata që vijnë që për një çerek ore të na tregojnë fatkeqësitë e jetës së tyre pak a shumë të gjatë, psikoanalisti nuk bën ndonjë gjë të madhe. Njohuritë e tij më të thella nuk e lejojnë t'i bjerë shkurt e t'i thotë të sëmurit, siç do të bënte ndonjë mjek tjetër:

"Jeni për bukuri!" dhe ta këshillojë të bëjë një kurë të lehtë hidroterapie. Njëri nga kolegët tanë pyetjes se çfarë bën ai me pacientët që i vijnë për konsultë, i përgjigjet duke ngritur supet: i këpus një gjobë prej kaq koronash për marrëzitë e tij. Kështu që mos u habisni kur dëgjoni se edhe te psikoanalistët, qoftë edhe te ai që ka më shumë punë gjatë konsultave, përgjithësisht nuk ka edhe aq njerëz. Unë kam ndërtuar midis dhomës së pritjes dhe kabinetit tim një derë të dyfishtë dhe kam urdhëruar që ajo të vishet me një copë liri. Nuk është e vështirë që kuptohet qëllimi i kësaj përshtatjeje. Dhe ndodh vazhdimisht që pacientët që kalojnë nga salla e pritjes në kabinetin tim, harrojnë të mbyllin të dyja dyert dhe prandaj gati gjithnjë ato mbeten hapur. Kur e vura re këtë dhe cilësinë shoqërore të personit, nuk vonova t'i bëj një vërejtje gjithë nervozizëm se ai apo ajo që hyri – qoftë ky zotëri elegant apo zonjë tepër e bukur – të kthehet të ndreqë gabimin. Kjo krijon përshtypjen e një pedantizmi pa kuptim. Më ka ndodhur që kjo kërkesë të më ketë vënë disa herë në pozitë të vështirë, pasi kanë qenë njerëz që vetë nuk e kishin mundësinë ta mbyllnin vetë derën dhe ka qenë fat i tyre që kanë qenë të shoqëruar me njerëz të tjerë që e kanë kryer këtë veprim. Por, në shumicën e rasteve, ka qenë e drejtë, sepse ai që e lë hapur derën që lidh dhomën e pritjes me kabinetin e mjekut, bën pjesë në grupin e njerëzve të paedukuar dhe që meriton prirjen më të pasjellshme. Mos merrni menjëherë anën e tyre pa i dëgjuar të gjithë. Kjo pakujdesi e pacientit ndodh vetëm në rast se ai është vetëm në dhomën e pritjes dhe lë pas një dhomë të zbrazët, por kjo nuk ndodh asnjëherë në qoftë se bashkë me të presin edhe njerëz të tjerë. Në këtë rast të fundit ai e kupton shumë mirë se është në interes të tij që të mos përgjohet kur flet me mjekun, dhe ai asnjëherë nuk do të harrojë të mbyllë me kujdes të dyja dyert.

Kjo lënie e pacientit e paraqitur në këtë mënyrë, nuk është e rastit e madje as e parëndësishme sepse, siç do ta shohim,

ajo përcakton marrëdhëniet ndërmjet pacientit dhe mjekut. Pacienti bën pjesë në atë numër njerëzish që kërkon nga mjeku një pushtet të vërtetë e që dëshiron të jetë i verbuar, i trembur. Mbase, duke pyetur në telefon se në ç'orë e ka më mirë të vijë, ai mendonte të shikonte një turmë njerëzish që kërkojnë ndihmë si para filialit të firmës së Julius Majnlit. Dhe më në fund ai hyn në një dhomë të zbrazët, e veç kësaj të mobiluar jashtëzakonisht thjesht, dhe tronditet. Ai duhet ta detyrojë mjekun t'ia paguajë që kishte ndërmend të sillë me të me një nderim tepër të madh, mirëpo ja që harron të mbyllë derën midis dhomës së pritjes dhe kabinetit të mjekut. Me këtë ai dëshiron t'i thotë mjekut: oh, po këtu s'paska njeri dhe me siguri që s' do të vijë askush sa të jem unë. Dhe gjatë bisedës do të sillë jo me aq edukatë e pa respekt, në qoftë se nuk do t'i thyhej hunda që në fillim me atë vërejtje therëse.

Në analizën e këtij veprimi psikoanalitik të parëndësishëm ju nuk do të gjeni asgjë që të mos e njihmi, dhe pikërisht pohimin se ai nuk është i rastit, po ka një motiv, një kuptim e një synim, që ai hyn në një lidhje shpirtërore të caktuar dhe dëshmon si tipar i parëndësishëm për një proces shpirtëror më të rëndësishëm. Por para së gjithash ky proces që shfaqet në këtë mënyrë, nuk njihet nga personi që e kryen atë sepse asnjëri nga pacientët që i ka lënë hapur të dyja dyert, nuk do ta pranonte që me këtë veprim ka dashur të shprehte mungesë respekti për mua. Një tjetër, mbase, edhe kujton ndjenjën e zhgënjimit që provoi kur hyri në dhomën e zbrazët të pritjes, por lidhja midis kësaj, mbase edhe veprimit simptomatik që e pason, me siguri ka mbetur e panjohur për të.

Kurse tani, për të konkretizuar këtë anomali të vogël të veprimit simptomatik, le të vëzhgojmë një të sëmurë. Po zgjedh një rast që e kam të freskët në kujtesë, dhe ngaqë ai mund të paraqitet relativisht qartë. Në çdo analizë të tillë nuk mund të shmangen disa hollësi.

Një oficer i ri që ka ardhur për ca kohë me leje, më kërkon t'i mjekoj njerikën, e cila, megjithë kushtet tepër të favorshme, po u helmonte jetën vetes dhe të afërmeve të saj, pasi e mundonte një ide absurde. Njihem me 53-vjeçaren e mbajtur mirë, me një karakter të lezetshëm e të thjeshtë, e cila më tregon pa e zgjatur historinë e mëparshme. Ajo jetonte larg qytetit dhe kishte bërë një jetë tepër të lumtur me të shoqin që drejtonte një fabrikë të madhe. Nuk mburrej se i shoqi ishte kujdesur shumë për të. Para 30 vjetësh ishte martuar me të me dashuri, dhe që atëherë nuk kishte patur asnjë keqkuptim, mosmarrëveshje apo arsye për xhelozë. Dy djem të saj ishin të lumtur në martesë, burri nuk vinte i qetë pasi e ndiente për detyrë të kujdesej për ta. Para një viti kishte ngjarë diçka e pabesueshme, që as ajo vetë s'e kish kuptuar: i kishte besuar një letre anonime, në të cilën burri i saj i bukur akuzohej për një lidhje dashurie me një vajzë të re dhe që nga kjo kohë lumturia e saj ishte prishur. Në hollësi puna qëndronte afërsisht kështu: ajo kishte një shërbetore, me të cilën ajo bënte shpesh biseda intime. Kjo vajzë përdiqte një tjetër me një armiqtësi të jashëzakonshme, sepse kishte ecur shumë më tepër në jetë, ndonëse kishte origjinë familjare gati njësoj si ajo. Në vend që të hynte në punë, ajo kishte vazhduar shkollën tregtare, kishte hyrë në fabrikë dhe për mungesë personeli, ngaqë nëpunësit ishin thirrur në shërbim ushtarak, kishte zënë një vend shumë të mirë. Tani ajo banonte në fabrikë, vërtitej midis zotërinjve dhe madje quhej zonjushë. Natyrisht, vajza që nuk i kishte ecur në jetë, ishte gati t'i sajonte shoqes së saj të shkollës lloj-lloj ndyrësish.

Një herë zonja jonë kishte biseduar me shërbetoren për një zotëri të vjetër që kishte qenë te ta për vizitë, të cilën e dinin që nuk jetonte me të shoqen, por kishte lidhje me një grua tjetër. Ajo nuk e di se si i ka shpëtuar që papritmas ka thënë: "Për mua do të ishte e tmerrshme po të mësoja që edhe burri im i mirë ka

një lidhje të tillë“: Të nesërmen kishte marrë një letër anonime, në të cilën njoftohej me shkrim të ndryshuar lajmi që e kishte shqetësuar kaq shumë. Ajo ishte menduar, dhe besojmë me plot të drejtë, që letra ishte vepër e shërbetores së saj të keqe, sepse dashmore e burrit në letër quhej pikërisht zonjusha, të cilën shërbetoria e përdiqte me urretjen e saj. Por, ndonëse e kishte patur të qartë menjëherë gjithë tablonë dhe njihte disa raste që tregonin se sa pak vëmendje u duhej kushtuar të tilla trillimeve, kishte ndodhur që kjo letër e kishte goditur thellë, ishte nxehur aq shumë, sa që kishte thirrur me shpejtësi të shoqin dhe i kishte zbratur një lumë qortimesh nga më të ashprat. I shoqi e kishte mohuar akuzën duke qeshur dhe kishte bërë të pamundurën për ta qetësuar të shoqen. Kishte thirrur mjekun e shtëpisë e të fabrikës, i cili ishte përpjekur t' u shpjegonte se këto ishin dokrra. Edhe veprimet e mëtejshme të të dyve kishin qenë tepër të arsyeshme. Shërbetoria u dëbua nga shtëpia, por rivalja e imagjinuar mbeti. Që nga ajo kohë e sëmura ishte qetësuar aq shumë, sa që thoshte se nuk e besonte më përmbajtjen e letrës anonime, por ky qetësim nuk kishte qenë gjithnjë i plotë e i gjatë. Mjaftonte të përmendej emri i zonjushës apo të takohej ajo në rrugë që të fillonte të shpërthente përsëri, duke dyshuar, sharë e rënkuar.

Ja historia e sëmundjes së kësaj gruaje. Nuk nevojitet ndonjë përvojë e madhe psikiatrike për të kuptuar që në kundërshtim me të sëmurët e tjerë psikoneurotikë ajo e paraqiste sëmundjen e saj tepër butë, sikur bisedonte, nuk shtirej, dhe se në thelb ajo nuk e kishte humbur asnjëherë besimin te akuzat e letrës anonime.

Çfarë qëndrimi do të mbajë psikiatri në këtë rast sëmundjeje? Si do të veprojë ai në rastin e një veprimi simptomatik të pacientit që nuk mbyll derën e dhomës së prijtes, siç e dimë? E shpall një rastësi pa interes psikologjik që nuk i takon fare. Por në rastin e gruas xheloze një qëndrim i tillë nuk

mund të mbahet. Veprimi simptomatik duket diçka e parëndësishme, por te simptomat e sëmundjes shikohet diçka e rëndësishme. Ai lidhet me vuajtjen subjektive intensive, ai kërcënon objektivisht jetën e përbashkët familjare, kështu që është objekt i interesit të pashmangshëm për psikiatrin. Në fillim psikiatri orvatet ta karakterizojë simptomën sipas vetisë së saj thelbësore. Ndërsa ideja që e mundon këtë grua, nuk mund të quhet absurde; se ndodh që burra jo të rinj lidhin marrëdhënie dashurie me vajza të reja. Por këtu diçka tjetër është absurde dhe e pakuptueshme. Pacientja nuk ka asnjë arsye tjetër përveç faktit të një letre anonime që të besojë se bashkëshorti i saj i ëmbël e besnik hyn në këtë kategori tepër të rrallë burrash. Ajo e di se kjo letër nuk ka asnjë forcë argumentuese, mund ta shpjegojë në mënyrë të kënaqshme origjinën e saj, ajo do të duhej ta bindte veten se nuk ka asnjë arsye për xhelozin, ia thotë këtë vetes e megjithatë vuan njësoj sikur ta quante këtë xhelozin krejt të përligjur.

Idetë e këtij lloji që nuk u nënshtrohen argumenteve logjike e që nisen nga realiteti, është bërë zakon të quhen *ide të çmendura*. Në këtë mënyrë, zonja e dashur vuan nga *marrëzia e xhelozisë*. Kjo është, pra, karakteristikë më e rëndësishme e këtij rasti sëmundjeje.

Pas këtij konstatimi të parë interesi ynë psikiatrik sikur rritet edhe më shumë. Në qoftë se idesë së çmendur nuk mund t'i jepet fund duke iu referuar realitetit, atëherë ajo, në fakt, nuk ka rrënjë në realitet. Po nga vjen atëherë? Idetë e çmendura kanë përmbajtje nga më të larmishmet. Pse në rastin tonë përmbajtja e çmendurisë është pikërisht xhelozia? Kuji i lindin ide të çmendura dhe, në veçanti, idetë e çmendura të xhelozisë? Këtu do të dëshironim të dëgjonim psikiatrin, por pikërisht këtu ai do të na e hedhë. Në përgjithësi ai do të ndalet vetëm në njërën nga çështjet tona. Ai do të studiojë historitë e familjes së kësaj gruaje, mbase, do të na përgjigjej: ide të çmendura kanë

ata njerëz, në familjen e të cilëve janë ndeshur më se një herë çrregullime të tilla ose të thella psikike. Me fjalë të tjera, në qoftë se te kjo grua është zhvilluar një ide e çmendur, te ajo ka patur një predispozicion të trashëguar. Natyrisht, kjo është diçka, po a është e gjitha që duam të dimë? E gjitha që ka shërbyer si shkak i sëmundjes? A duhet të mjaftohemi me supozimin se në qoftë se në vend të një çmendurie tjetër është zhvilluar ajo e xhelozisë nuk ka rëndësi nëse është rastësi dhe e pashpjegueshme? Dhe a duhet ta kuptojmë tezën që predikon mbizotërimin e ndikimit të trashëguar edhe në kuptimin negativ: s'ka rëndësi se çfarë përjetimesh e kanë tronditur këtë shpirt, mos ishte e paracaktuar që ajo do të sëmurëj dikur nga marrëzia? Ju do të dëshironi të mësoni se pse psikiatria shkencore nuk do të japë fare shpjegime të mëtejshme. Por unë do t'ju përgjigjem: është i lig ai që jep më shumë se ç'ka. Dhe psikiatri as që e di rrugën që të çon në kuptimin e mëtejshëm të këtij rasti. Ai është i detyruar të mjaftohet me diagnozën dhe me prognozën e pasigurtë të rrjedhës së mëtejshme të sëmundjes, megjithë përvojën e pasur.

Por a ka mundësi psikoanaliza të arrijë më shumë në këtë rast? Patjetër që ka; shpresoj t'ju tregoj se edhe në një rast kaq të vështirë ajo është në gjendje të zbulojë diçka që na jep mundësinë e depërtimit më të thellë në thelbin e çështjes. Së pari, kërkoj t'ju tërheq vëmendjen mbi hollësinë e parëndësishme që pacientja e ka provokuar hapur letrën anonime, mbi të cilën mbështetet ideja e çmendur, duke ia treguar më parë intrigantes idenë se për të do të ishte një fatkeqësi tepër e madhe në qoftë se i shoqi do të kishte lidhje dashurore me një vajzë të re. Me këtë ajo i çoi në mendje shërbetores t'i dërgonte asaj një letër anonime. Kështu që një ide e çmendur fiton njëfarë pavarësie nga letra anonime; atë e kishte e sëmura qysh më përpara saj në formën e frikës – apo të dëshirës. Shtojini kësaj edhe atë që dhanë dy orë analizë të

aluzioneve të tjera të parëndësishme. Është e vërtetë që pacientja u soll tepër negativisht ndaj kërkesës pas rrëfimit të historisë së saj për të bërë arsyetime të mëtejshme, për të dhënë mendimet dhe kujtimet që i vinin ndërmend. Ajo thoshte se nuk i vinte asgjë ndërmend, që i kishte thënë të tëra, dhe pas dy orësh orvajtja për të vazhduar bisedën me të u detyrua të ndërpritej krejt, meqenëse deklaroi se tani ndihej mirë dhe ishte e sigurt që ideja e sëmurë nuk do t'i shfaqej më. Natyrisht, ajo e tha këtë vetëm nga qëndresa dhe frika e vazhdimit të analizës. Por megjithatë gjatë këtyre dy orëve ajo lëshoi disa vërejtje që lejojnë të bëhet një interpretim i caktuar, madje e bëjnë atë të pashmangshëm, dhe ky interpretim hedh dritë të qartë mbi burimin e marrëzisë së saj të xhelozisë. Ajo kishte qenë vetë e dashuruar fort pas djaloshtit, pikërisht të atij dhëndrri, më këmbënguljen e të cilit m'u drejtua mua si paciente. Për këtë dashuri ajo as që kishte dijeni ose, ndoshta, dinte shumë pak; në marrëdhëniet familjare ekzistuese kjo dashuri mund të maskohej lehtë si ëmbëlsi e pafajshme. Duke pasur parasysh përvojën tonë, ne nuk e kishim të vështirë të depërtonim në jetën shpirtërore të kësaj gruaje të rregullt 53-vjeçare dhe nënë të mirë. Kjo dashuri, si diçka e përbindshme, e pamundur, nuk mund të bëhej e vetëdijshme; por ajo mbetej dhe si e pavetëdijshme, qëndronte si peshë e rëndë. Diçka duhej të ndodhte me të, duhej gjetur një rrugëdalje, dhe lehtësimin më të thjeshtë e dha mekanizmi i zëvendësimit, i cili merr pjesë kaq shpesh në lindjen e xhelozisë së sëmurë. Në qoftë se jo vetëm ajo, grua e vjetër, ishte dashuruar pas një burri të ri, po edhe burri i saj i vjetër kishte lidhje dashurore me një vajzë të re, ajo do të çlirohej nga brejtja e ndërgjegjes për pabesi. Në këtë mënyrë fantazia e pabesisë së burrit ishte një kompresë ftohëse për plagën e saj përvëluese. Për dashurinë e saj ajo nuk ishte e vetëdijshme, por pasqyrimin e saj që i jepte të tilla avantazhe, ajo e kuptonte në trajtën e kllapisë së një çmendurie obsesionale.

largët në vend që të na tregojë shkaqet më të shpeshta e më të afërta. Po mos ka këtu një kontradiktë? Mos kjo është më tepër një përsosje? Mos vallë pranimi i faktorit të trashëgimisë dobëson rolin e përjetimit? Mos këta dy faktorë bashkohen në mënyrën më efektive? Ju do të pajtoheni me mua që, në thelb, në punën psikiatrike nuk ka asgjë që do t'i kundërvihet studimit psikoanalitik. Kështu që janë psikiatrit që i kundërvihen psikoanalizës dhe jo psikiatria. Psikoanaliza lidhet me psikiatrinë afërsisht ashtu si histologjia me anatominë: njëra studion format e jashtme të organeve, tjetra ndërtimin e tyre prej indeve e pjesëve elementare. Kontradikta midis këtyre lloj studimesh, njëri prej të cilave vazhdon tjetrin, është vështirë të përfytyrohet. Ju e dini se sot anatomia quhet bazë e mjekësisë shkencore, por ka qenë një kohë kur hapja e kufomës ishte po aq e ndaluar sa ç' duket sot e çuditshme të merresh me psikoanalizën për të njohur mekanizmin e brendshëm të jetës shpirtërore. Dhe ndoshta në një të ardhme jo të largët do ta kuptojmë që një psikiatri thellësisht shkencore është e pamundur pa njohje të mirë të proceseve të pavetëdijshme të jetës shpirtërore që qëndrojnë në thellësi.

Ndoshta midis jush ka përkrahës të psikoanalizës kaq të urreyer, të cilëve do t'u pëlqejë në rast se do të arrihej që mjekimi të bëhej në mënyrë terapeutike. Por ju e dini se terapia e sotme psikiatrike nuk është në gjendje të veprojë mbi idetë fikse. Ndoshta në sajë të pikëpamjeve të saj mbi mekanizmin e formimit të simptomave psikoanaliza është në gjendje ta bëjë këtë? Jo, zotërinj, ajo nuk e bën dot këtë; ajo është po aq e pafuqishme kundër sëmundjeve sa edhe çdo terapi tjetër, të paktën tani për tani. Ndonëse mund ta kuptojmë se ç'ka ngjarë me të sëmurin, prapëseprapë nuk kemi asnjë mjet për ta bërë atë të kuptueshëm për vetë të sëmurët. Ju keni dëgjuar që unë vetëm sa arrita ta nis analizën e kësaj ideje obsesionale. A do të pohoni për këtë arsye se analiza e këtyre rasteve nuk duhet sepse është

pa rezultat? Unë mendoj se ende jo. Ne kemi të drejtë, madje detyrë të bëjmë studime pa llogaritur një efekt të dobishëm të drejtpërdrejtë. Në fund të fundit ne nuk e dimë ku dhe kur çdo pjesëz e dijës do të kthehet në mundësi terapeutike. Në qoftë se psikoanaliza do të ishte po aq e pasuksesshme në të gjitha format e tjera të sëmundjeve nervore e psikike, si në fushën e ideve obsesionale, ajo, megjithatë, do të mbetej plotësisht e përligjur si mjet i pazëvendësueshëm i studimit shkencor. Ndonëse atëherë nuk do të ishim në gjendje ta zbatonim atë; njerëzit, nga të cilët duam të mësojmë, janë njerëz të gjallë, me vullnetin e tyre e që marrin pjesë në këtë punë për motivet e tyre, do të kundërshtonin. Prandaj sot më lejoni ta mbyll këtë leksion me njëftimin se ka grupe të mëdha çrregullimesh nervore, ku ne do të kishim mundësi t'i mëshironim realisht dijet tona në zotësi terapeutike, dhe se në kushte të caktuara, në rastet e këtyre sëmundjeve që mezi kurohen, po arrijmë suksese që nuk mbeten aspak pas të tjerave në fushën e terapisë së brendshme.